

KARLOS RUIZ ZAFON, TRAJEKTORJA E TIJ LETRARE DHE SUKSESI I JASHTËZAKONSHËM NË SHQIPËRI

Dr. Flavia Kaba

Departamenti Gjuhës Spanjolle
Fakulteti Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: flavia.kaba@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Shkrimtari spanjoll Karlos Ruiz Zafon i përkthyer në mbi 45 gjuhë dhe i botuar në pesë kontinente, pasi u përkthye edhe në gjuhën shqipe, u mirëprit nga lexuesi shqiptar, të cilët, krijuan forume apo klube leximi për të ndarë ndjesitë e tyre mbi veprat zafoniane. Pena dhe stili zafonian të krahasuar me atë të Kunderës, Borgesit apo edhe Dikensit, korren një sukses të jashtëzakonshëm edhe në vendin tonë, sigurisht falë edhe përkthimeve dinjitoze të përkthyesve. Trajektorja letrare e Zafonit ndonëse e shkurtër në kohë, përbëhet nga 9 romane, 3 prej të cilave janë romane për të rinj, me të cilat Zafoni nisi edhe karrierën e tij si shkrimtar dhe një libër me tregime. Në këtë punim modest do të japim një panoramë mbi këtë trajektore letrare dhe suksesin e jashtëzakonshëm që korri Zafoni në Shqipëri.

Fjalët çelës: letërsi spanjolle bashkëkohore, përkthime, romane, Zafon etj.

ABSTRACT

Carlos Ruiz Zafon a Spanish novelist is translated into over 45 languages and published on five continents, after being translated into Albanian, it was also welcomed by the Albanian readers, who created forums or reading clubs to share their feelings on Zafonian works. The Zafonian pen and style is compared to that of Kundera, Borges or even Dickens, had a big success in our country as well, certainly thanks to the dignified translations of the translators. Zafoni's literary trajectory, although short in time, consists of 9 novels, 3 of which are novels for young people, with which Zafoni started his career as a writer and a book of stories. In this modest work, we will give an overview of this literary trajectory and the extraordinary success that Zafoni has in Albania.

Keywords: contemporary Spanish literature, novels, translations, Zafon etc.

Zafon dhe letërsia për të rinj

Lindi në qytetin e bukur të Barcelonës në vitin 1964. Në vitin¹ dhe qytetin e dragonjve të cilët aq shumë i deshi dhe i koleksionoi përgjatë gjithë jetës së tij duke i bërë pjesë të pandashme edhe në narrativën e tij letrare. Krijimtarinë letrare e nisi në vitin 1993 me botimin e romanit të parë për të rinj të titulluar ‘Princi i mjegullës’ i cili fitoi edhe çmimin Edebe.² Një vit më vonë ai do të transferohej në qytetin e Los Angeles të cilin aq shumë e kishte ëndërruar në fëmijërinë e tij. Nga qyteti i dragonjve në qytetin e engjëjve, simbole të cilat ndeshen shpesh edhe në narrativën e tij letrare duke i shndërruar deri diku edhe në personazhe gati-gati thelbësorë për veprat e tij. Në vitet pasardhëse, përkatësisht në vitin 1994 botoi romanin ‘Pallati i mesnatës’, një roman plot mistere sikurse edhe ai vetë e adhuronte misterin, një histori që zhvillohej në Kalkutën e viteve 30’, për të vazhduar më pas në vitin 1995 me publikimin e romanit po për të rinj ‘Dritat e shtatorit’, rrëfim mbi një fabrikues misterioz lodrash. Të tre këta libra për të rinj formuan *Trilogjinë e Mjegullës*. Në vitin 1999 do të botonte romanin *Marina*, një ndërthurje tipike e Zafonit mes tragjedisë dhe intrigës në Barcelonën e viteve 80’.

Romanet e sagës së Varrezës së Librave të Harruar

Zafon u bë i njohur ndërkombëtarisht me veprën *Hija e Erës*, roman i botuar në vitin 2001, romani i parë i sagës së Varrezës së Librave të Harruar, ku flitej mbi botën magjike të kësaj varreze, aty ku shumë lexues gjetën, humbën dhe rigjetën veten dorë për dorë me personazhet e romanit, i cili shiti në mbarë botën më shumë se 15 milion kopje duke e renditur kështu Zafonin, shkrimtarin e dytë më të lexuar pas Servantesit dhe romanin e tij *Hija e Erës* si romanin me shitjen më të madhe pas Don Kishotit. Një fenomen letrar për të cilin u shkrua pafund dhe për të cilin kritika letrare nuk hezitoi ta krahasonte narrativën dhe peshën e historive të personazheve të tij me shkrimtarët më të mëdhenj të të gjithë kohërave si Dikens, Borges, Kundera, Allan Poe, etj, aq sa tashmë Zafon njihet ndryshe edhe si Dikensi i Barcelonës.³ Libri u shndërrua në një *best-seller* në Spanjë, Shtetet e Bashkuara, Gjermani, Itali, etj. Pas një pushimi të gjatë prej gati shtatë vitesh, Zafon do të rikthehej me romanin e dytë të kësaj sage të titulluar ‘Loja e engjëllit’. Sërish ngjarjet do të zhvillohen në Barcelonën e Zafonit, një Barcelonë e turbullt dhe e trazuar e viteve 20’, ku një shkrimtar riosh i fiksuar pas një dashurie të pamundur do të pranojë ofertën

1 Sipas kalendarit kinez, njerëzit e lindur nga 13 shkurti i vitit 1964 dhe 1 shkurti i vitit 1965 i përkasin shenjës së Dragoit.

2 Çmimet Edebe i Letërsisë për Fëmijë dhe të Rinj, janë çmime që jepen nga Shtëpia Botuese Edebe për të promovuar veprat letrare për fëmijë dhe të rinj. www.edebe.com

3 Flavia Kaba: Et recordarem sempre, Carlos. Faleminderit Zafon. www.startnews.com

e një redaktori misterioz për të shkruar një libër që kurrë më parë nuk ka ekzistuar, në këmbim të një pasurie të madhe. Intriga, bota gotike, mistere, aventura dhe shumë pyetje pa përgjigje do të ngërthejnë sërish mijëra lexues anembanë botës. Saga do të shtohet me romanin e tretë pas tre vitesh, pikërisht në vitin 2011 me romanin e titulluar *I burgosuri i qiellit*. Një roman plot intriga por edhe emocione të forta të cilat ndihen që në faqet e para të romanit me shfaqjen e një personazhi sa misterioz po aq edhe shqetësues, i cili do të vizitojë librarinë e familjes Sempere dhe do t'i kërcënojë ata me zbulimin e një sekreti, i cili gjendet i varrosur prej dy dekadash në kujtesën e errët të qytetit. Romani i tretë i sagës së Varrezës së Librave të Harruar, është një hap më shumë drejt brendësisë së ngjarjeve, çka është dhe gërshetimi thelbësor në të cilin mbështeten edhe katër librat. Zafon ka dashur që secili prej romaneve të kishte veçantinë e vet, strukturë të ndryshme por që në të njëjtën kohë të kishin lidhje me njëri tjetrin. Në këtë rast, mbi të gjitha, si referencë për prezencën e personazhit të Ferminit, toni është më i lehtë, më pikaresk dhe narrativa ka një ritëm më të zhdërvjellhtë dhe më të shpejtë, krahasuar me dy romanet paraardhëse, një ndjesi që ka lidhje me natyrshmërinë e rrëfimit, i cili është një kreshendo drejt finales së madhe që na pret në përfundimin e pjesës së katërt.⁴

Fundin e lënë të hapur te romani *I burgosuri i qiellit*, lexuesit do ta gjejnë të mbyllur te romani fundit i sagës *Labirinti i shpirtrave*, i botuar në vitin 2016, plot pesëmbëdhjetë vite pas botimit të romanit të parë të sagës së Varrezës së Librave të Harruar, roman i vendosur në Barcelonën e regjimit të Frankos të fund viteve 50', ku do të zbulohet historia e familjes së personazheve duke i dhënë kështu prekjen përfundimtare kësaj sage. Në këtë roman përmbyllës të sagës, lexuesit do të ritakohen me personazhet e njohura edhe në romanet e mëparshme, me tema të cilat do të fillojnë të gjejnë zgjidhje sikurse edhe shumë pyetje do të marrin përgjigjet e munguara.

Tregimet e Zafonit, të botuara para dhe pas vdekjes së tij

E nisi krijimtarinë e tij letrare me romane për të rinj për të vazhduar më pas me romanet për të rritur dhe sakaq gjatë udhëtimit të tij letrar, fatkeqësisht të shkurtër, në vitin 2020, nën titullin *Qyteti i avullit*, Zafonit iu botuan në shenjë homazhi për të gjithë lexuesit e tij por edhe lamtumire, edhe disa tregime, katër prej të cilave nuk ishin botuar më parë. Karlos Ruiz Zafon e konceptonte këtë vepër, përveç se në vetvete, si një mirënjohje për lexuesit e rij, të cilët e kishin ndjekur përgjatë gjithë sagës që filloi me *Hija e erës*. Sot, për shkak të karakterit postum të botimit, shndërrohet edhe në një homazh të shtëpisë botuese për vetë Autorin, një mirënjohje së cilës, me siguri, do t'i bashkohen lexuesit e njërit prej shkrimtarëve më të admiruar të kohës sonë.⁵

4 Gazeta Shqiptare, Të katra historitë e mia. fq. 27, 2 dhjetor 2012

5 Flavia Kaba, *Qyteti i avullit*, Shtëpia Botuese Dituria, fq. 7, 2021

Këto tregime risollën atmosferën, vendet, personazhet, misteret, terrin, botën gotike, etj. që u formësuan dhe rrodhën nga tetralogjia e Varrezës së Librave të Harruar. *Gaudi në Manhattan* njëri nga tregimet, u botua në vitin 2002 në faqet e së përditshmes spanjolle *La Vanguardia*, duke qenë se Barcelona e shpalli vitin 2002⁶ si vitin ndërkombëtar të Gaudit për të përkujtuar arkitektin e famshëm spanjoll në 150 vjetorin e tij të lindjes. Po kjo e përditshme spanjolle do të botonte edhe një tjetër tregim të Zafonit, *Legjenda e Krishtlindjes*.

Këto dy tregime, së bashku me *Gruaja e avullt* – të shfaqura te e përditshmja *El País* – dhe *Alisia në agim*, asokohe e pabotuar, formësuan librin e vogël *Barcelona Gotike*, botuar nga Librat e Vanguardia dhe Librat Renfe brenda projektit “tregime në tren” të vitit 2008, për të nxitur leximin hekurudhor.

Po atë vit, *Shtëpia Botuese Planeta* realizoi një edicion promovues të *Alisia në agim* së bashku me tregimin *Burra në gri*. Gjithashtu në edicionin e Planeta u shfaq në vitin 2012 tregimi i gjatë, pothuajse një *nouvelle*, *Princi i Parnasit*, i vendosur në Barcelonën e shekullit të XVI dhe me personazh Migel de Servantes, ku Ruiz Zafon shënjoj gjurmët mbi gjenezën e Varrezës së Librave të Harruar, kontribut i tij tashmë i pashlyeshëm në mitologjinë letrare.

Një tjetër tregim, paksa më i shkurtër, *Trëndafili i zjarrit*, u shfaq në revistën *La Vanguardia* në vitin 2012.⁷

Zafon, sukses i jashtëzakonshëm në Shqipëri

Shkrimtari spanjoll bashkëkohor është përkthyer në mbi 45 gjuhë të huaja dhe në të pestë kontinentet dhe në Shqipëri ky kolos i letërsisë spanjolle ka ardhur falë botimeve të Shtëpisë Botuese Dituria. Botimet e Zafonit, ndryshe nga trajektorja e tij letrare e lartpërmendur me datat përkatëse për çdo botim, në Shqipëri janë sjellë deri diku me disa ndryshime datash, kjo si rrjedhojë e kohës që i është dashur qoftë shtëpisë botuese për marrjen e të drejtave të autorit por edhe përkthyesit për të sjellë të shqipëruar veprën zafoniane. Ndërkohë që në Spanjë libri që i solli famën ndërkombëtare u botua në vitin 2001, *Hija e erës*, te ne, do të vinte aq mjeshtërisht e përkthyer nga i madhi dhe i ndjeri Ardian Klosi nga gjuha gjermane në vitin 2006. Si një hije që fryn mbi ne, për të ringjallur dashurinë, për veten dhe të tjerët. Vjen e nuk mundet të ndalet, edhe kur ata që duan ta mbajnë i kanë drejtuar armën e kohës moderne: harresën e fjalës dhe dashurisë! Ky do të jetë gjithnjë shkrimtari, ose më saktë, pasoja e shkrimtarit – fjala -, të cilën moderniteti kërkon ta lërë në një stacion ku trenat nuk nisen e mbërrijnë kurrë. Por era e dashurisë për fjalën dhe fuqinë e saj do ta fryjë. Do ta fryjë për të ecur gjithnjë më shpejt se treni

6 https://elpais.com/cultura/2002/06/02/actualidad/1022968801_850215.html

7 https://www.elespanol.com/cultura/20201117/pistas-carlos-ruiz-zafon-relatos-ineditos-postuma/536697306_0.html

modern i pafjalësisë.⁸

Romani i dytë i sagës i përkthyer po aq mjeshtërisht nga përkthyesja Ledia Dushi nga gjuha italiane, do t'i prezantohet lexuesit shqiptar në vitin 2009 për të vazhduar më pas me veprën e tretë të kësaj sage nën titullin *I burgosuri i qiellit*, përkthyer nga Flavia Kaba nga gjuha origjinale e veprës, gjuha spanjolle, sjellë për lexuesin shqiptar në vitin 2012.

Sakaq, në vitin 2011, Ledia Dushi do të sillte në shqip librin *Marina* dhe në vitin 2014 Flavia Kaba do të sillte në shqip tre romanet e para për të rinj, me të cilat Zafon nisi karrierën e tij si shkrimtar, tre libra që u botuan në një botim të vetëm nën titullin *Trilogjia e mjegullës*.

Lexuesi shqiptar do të duhej të priste edhe shtatë vite të tjera për t'i dhënë fund kureshtjes mbi këtë sagë dhe pritjes kaq të gjatë me botimin e romanit përmbyllës të sagës nën titullin *Labirinti i shpirtrave*, sjellë në shqip sërish nga Flavia Kaba në vitin 2019.

Sakaq, lajmet se Zafon ishte duke përgatitur një tjetër roman për lexuesit e tij e ndërsa lexuesit në mbarë botën teksa e prisnin këtë botim i riktheheshin leximit të veprave të botuara, më 19 qershor të vitit 2020, të gjithë zafondashësit do të tronditeshin nga lajmi i ndarjes së parakohshme nga jeta e këtij kolosi letrar. Në moshën 55 vjeçare, pas dy vitesh lufte të vazhdueshme me sëmundjen e keqe, Zafon do të dorëzohej për t'u ndarë kaq herët dhe kaq papritur nga jeta. Shtëpia Botuese Planeta, së cilës Zafoni paraprakisht i kishte besuar mbledhjen dhe botimin e tregimeve të tij, mundësoi botimin postum të veprës *Qyteti i avullit*, përkthimi në gjuhën shqipe i të cilit erdhi sërish nën emrin e Flavia Kaba në vitin 2021.

Të gjitha romanet e Zafon tashmë janë përkthyer në gjuhën shqipe dhe janë mundësuar nga shtëpia botuese Dituria.

Hija e erës është botuar dhe ribotuar respektivisht në vitet 2006 me një tirazh prej 1500 kopje, në vitin 2009, 2013, 2016, 2018 dhe në vitin 2021 të njëjtin tirazh, 1500 për çdo ribotim.

Të njëjtin sukses ribotimi ka pasur edhe romani *Loja e engjëllit*, i cili botimin e parë e ka patur në vitin 2009 me një tirazh prej 2000 kopjesh për të vazhduar më pas në vitin 2013 me 1500 kopje, në vitin 2017 me 1000 kopje e së fundmi në vitin 2020 me 1500 kopje.

Libri për të rinj, *Marina*, do të sillej në gjuhën shqipe për herë të parë në vitin 2010 duke u botuar me një tirazh prej 1300 kopjesh për t'u ribotuar sërish në vitet 2014, 2017 dhe 2019 me një tirazh prej 1000 kopjesh. Romani i tretë i sagës së Varrezës së Librave të Harruar, *I burgosuri i qiellit* do të vinte për lexuesin shqiptar në vitin 2012 me një tirazh prej 1300 kopje, për t'u ribotuar më pas në vitin 2016 me 800 kopje dhe në vitin 2019 me 1200 kopje. Romani i fundit i sagës aq të dashur për lexuesin shqiptar, *Labirinti i shpirtrave*, do të botohej për herë të parë në vitin 2019 me një tirazh prej 2000 kopje.

Trilogjia e mjegullës, botimi ku janë përfshirë tre librat e parë të krijimtarisë së Zafonit, përkatësisht, *Princi i mjegullës*, *Pallati i mesnatës* dhe *Dritat e shtatorit*, do të botohej në vitin

2014 me një tirazh prej 1300 kopje, për t'u ribotuar më pas në vitin 2015 dhe në vitin 2019 me nga 800 kopje. E gjithë krijimtaria zafoniane do të mbyllet me botimin postum të librit të tij me 11 tregime, *Qyteti i avullit*, i cili u botua në vitin 2021 me një tirazh prej 1300 kopje.

Në shtypin vendas secili prej botimeve do të kishte jehonën përkatëse me tituj kumbues sikurse do të krijoheshin edhe shumë grupe apo forume zafondashëse në rrjetet sociale që, edhe sot, pas thujse një viti nga ndarja nga jeta e Zafonit vazhdojnë ende të diskutojnë dhe shkruajnë mbi këtë ikonë letrare spanjolle.

Nuk kishte si të ndodhte ndryshe me këtë shkrimtar bashkëkohor spanjoll i cili jetën e tij letrare ia kushtoi lexuesit duke ia fituar zemrën me të gjithë romanet e tij. Edhe lexuesi shqiptar e priti me një entuziazëm të pashoq këtë shkrimtar duke i dhënë atij meritat e merituar dhe të njohura edhe nga ndërkombëtarët.

Kritikët ndërkombëtarë e kanë pozicionuar sagën e Varrezës së Librave të Harruar në kategorinë e “klasikëve bashkëkohorë” duke e cilësuar veprën e tij si një nga universet letrare më emocionuese të shekullit të ri.

Jehona e romaneve të Zafonit nuk do të shuhet kurrë edhe sepse jeta e tij u shua përgjithmonë duke lënë ndezur shpirtin që endet në labirintin e jetëve të çdo lexuesi. I paharruar do të jetë dhe do të kujtohet përherë në labirintet e jetëve dhe shpirtave të çdo lexuesi anembanë.

Sikurse shkruante Zafon edhe në romanin e tij *Hija e erës*, “ekzistojmë për aq kohë sa dikush na kujton”, për aq kohë do të kujtohej edhe i madhi letërsisë spanjolle Karlos Ruiz Zafon.

BIBLIOGRAFÍA

- Gazeta Shqiptare, *Të katra historitë e mia*, fq. 27, 2 dhjetor 2012
- Kaba, Flavia, Et recordarem sempre, Carlos. Faleminderit Zafon. www.startnews.com
- Kaba, Flavia, *Qyteti i avullit*, Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë 2021.
- Ruiz Zafon, Carlos, *Hija e erës*, Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë 2006.
- Ruiz Zafon, Carlos, *Loja e engjëllit*, Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë `2009.
- Ruiz Zafon, Carlos, *I burgosuri i qiellit*, Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë 2012.
- Ruiz Zafon, Carlos, *Labirinti i shpirtrave*, Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë 2019.
- Ruiz Zafon, Carlos, *Trilogjia e mjegullës*, Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë 2014.
- Ruiz Zafon, Carlos, *Marina*, Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë 2014.
- Ruiz Zafon, Carlos, *La sombra del viento*, Shtëpia Botuese Planeta, Barcelonë 2001.
- Ruiz Zafon, Carlos, *El juego del angel*, Shtëpia Botuese Planeta, Barcelonë 2008.
- Ruiz Zafon, Carlos, *El prisionero del cielo*, Shtëpia Botuese Planeta, Barcelonë 2011.
- Ruiz Zafon, Carlos, *El laberinto de los espíritus*, Shtëpia Botuese Planeta, Barcelonë 2016.
- Ruiz Zafon, Carlos, *El príncipe de la niebla*, Shtëpia Botuese Edebé, Barcelonë 1993.
- Ruiz Zafon, Carlos, *El palacio de la medianoche*, Shtëpia Botuese Edebé, Barcelonë 1994.
- Ruiz Zafon, Carlos, *Las luces de septiembre*, Shtëpia Botuese Edebé, Barcelonë 1995.
- Ruiz Zafon, Carlos, *Marina*, Shtëpia Botuese Edebé, Barcelonë 1999.
- Ruiz Zafon, Carlos, *La ciudad de vapor*, Shtëpia Botuese Planeta, Barcelonë 2020.

SITOIGRAFÍA

- www.carlosruizzafon.com
- www.edebe.com
- https://www.lespanol.com/cultura/20201117/pistas-carlos-ruiz-zafon-relatos-ineditos-postuma/536697306_0.html
- www.pressreader.com
- https://elpais.com/cultura/2002/06/02/actualidad/1022968801_850215.html